

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Po vendoset kush bëhet kampion!" – Ballkani me akuza të rënda
ADRESA	https://www.koha.net/futboll/ballkani-mjaft-kemi-heshtur-referet-po-e-percaktojne-sezoni
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 01:47:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 18:50:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6752125fb96349c847ac9dc9cdbb7ecf3fbf1128edff66c4d758e3015b24f72b
TEKSTI	a8713d335c2252337f63bdc02e425ef0b44fdf5a848746f35c8f350c6f21ed9
PAMJA	e3e7149c693d3ba70becd5392a90ac57328b3710130a36ef52a08a51f4661a16

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d03c1864fcd29f5767f6d3f73f9de2acf19a9c37eaf125cc8f88fd6743370c6b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1e2948ee29ab13edbd442d93c043487a99670263e579192fb4ff737734c16e45
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d03c1864fcd29f5767f6d3f73f9de2acf19a9c37eaf125cc8f88fd6743370c6b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

FUTBOLL

“Po vendoset kush bëhet kampion!” – Ballkani me akuza të rënda



19 shtator 2026 20:50

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Ballkani ka reaguar ashpër pas ndeshjes së fundit ndaj Malishevës, duke ngritur akuza të rënda ndaj arbitrave dhe strukturave të referimit në futbollin kosovar.

Ballkani ka përmendur në mënyrë të veçantë kryeshefin e referimit, Përparim Hasanin.

Klubi nga Suhareka ka ngritur akuza të rënda ndaj strukturave të referimit në futbollin kosovar, duke pretenduar se edhe këtë edicion po tentohet të ndikohet në garën për titullin e kampionit dhe vendet që dërgojnë në garat evropiane.

Në reagimin e klubit pas ndeshjes, Ballkani ka kritikuar Hasanin duke pretenduar se ai, së bashku me persona që klubi i quan “piunë”, ka nisur që në fillim të kampionatit të ndikojë në rrjedhën e garës.

Reagimi i klubit është përqendruar edhe te ndeshja ndaj Malishevës, ku Ballkani ka vënë në pikëpyetje disa vendime të ekipit të arbitrave.

Edhe



Futboll • 19 pri 2026

Malisheva i afrohet zonës së Evropës pas fitores ndaj Ballkanit

Sipas klubit, në minutën e 52-të, Valentin Serebe, është rrëzuar në zonën e 16-metërshit pas një ndërhyrjeje që, sipas vlerësimit të Ballkanit, mund të ishte ndëshkuar me penallti.

Në vend të penalltisë, arbitri kryesor, Alban Shala, e ka ndëshkuar Sereben me karton të verdhë për simulim.

Ballkani u mposht nga Malisheva me rezultatin 2:1.

Reagimi i plotë:

Sezonin e kaluar kemi heshtur. Kemi heshtur edhe pse na është vjedhur titulli. Por tani ka ardhur koha të reflektojmë, sepse

Showbiz.

“Animals” e rikthen yllin Ben Affleck si regjisor

Futboll.

Rrahmani zëvendësues, Lazio mposht Venejian

Futboll.

Raphinha i pandalshëm, Barça fiton 3:1 ndaj Sevilias

Shtojca për Kulturë.

Kur pikëllimi shndërrohet në krenari

Arbëri.

Kurti: Nevojitet strategji shtetërore për reagim ndaj verdiktit të Speciales

Basketboll.

Bora e nis edicionin e ri me fitore të thellë

Kryeshefi i referimit, Përparim Hasani, me ekipen e tij, sezonin e kaluar na ka dëmtuar në 13 ndeshje direkte, në të cilat na janë vjedhur pikët dhe, si pasojë, e kemi humbur titullin. Po ashtu, na është vjedhur edhe Kupa e Kosovës. Nëse nuk jemi të saktë 100% në këto të dhëna, le t'i marrin ekspertët botërorë dhe t'i shikojnë të gjitha 36 lojërat e Superligës. Nëse nuk del e saktë kjo, ne do të dalim publikisht të kërkojmë falje.

Këtë sezon, kryeshefi, së bashku me piunet e tij, paska nisur që në fillim të kampionatit ta bëjë ligjin në futboll dhe të vendosë, sikurse sezonin e kaluar, se kush do të bëhet kampion dhe kush do të luajë në Evropë.

Edhe pse sezonin e kaluar kemi dërguar e-mail zyrtarë me kërkesën që disa gjyqtarë të mos delegoheshin në ndeshjet tona, për çudi, pikërisht ata gjyqtarë na delegoheshin në xhiron e radhës.

Tani më nuk mund të heshtim, sepse po dëmtohet djersa jonë – djersa e të gjithëve: e lojtarëve, stafit, investitorit dhe tifozëve.

Ne nuk kemi absolutisht asgjë kundër klubit të Malishevës. Ua urojmë pikët e plota, sepse jemi të bindur se ata nuk kanë dorë në referimin e sotëm. Por, për matematikat e atyre që qëndrojnë më lart, sot ata dolën fitimtarë.

Sot është vendosur ndeshja 100% nga Alban Shala dhe Valon Bajgora.

Në minutën e 52-të, Valentin Serebe rrëzohet në zonën e Malishevës pas një ndërhyrjeje që, nga pamjet, duket e mjaftueshme për akordimin e penalltisë. Një penallti që do të na jepte mundësinë të avanconim në 0-2.

Në vend të kësaj, gjyqtari kryesor, Alban Shala, e ndëshkoi Sereben me karton të verdhë për simulim. Edhe më i dhimbshëm është fakti se nga dhoma e VAR-it, ku ndodhej Valon Bajgora, nuk pati ndërhyrje apo reagim për rishikimin e këtij vendimi.

Edhe



Futboll • 14 dhj 2025

Ballkani thellon krizën e Prishtinës dhe forcohet në krye

Gjithashtu, në minutat e fundit, pas një goditjeje nga këndi, sipas vlerësimit tonë, ndaj lojtarit tonë shkatohet faull në zonë. Pikërisht nga vazhdimi i këtij aksioni vjen goli.

Dhe kështu, këta “heronj” e përfundojnë misionin e tyre, pikërisht ashtu siç duket se ishte paracaktuar para fillimit të ndeshjes.

E dimë se ky reagim, për shkak të ashpërsisë së tij, ndoshta nuk do t'i pëlqejë as Federatës së Futbollit të Kosovës. Por kemi vendosur të reagojmë kaq fuqishëm, sepse besojmë se ky është momenti i fundit për të reflektuar dhe për ta rregulluar njëherë e përgjithmonë çështjen e referimit.

Por jemi të mërzitur.

Krejt opinioni shqiptar, kudo në botë, e di se si futbolli i Kosovës është njohur dhe përfaqësuar në arenën evropiane përmes klubit tonë. Të gjithë e dinë se si kemi performuar në Evropë dhe çfarë historie kemi shkruar. Kur klubet e tjera ishin vetëm vizitore në Evropë, FC Ballkani garonte, fitonte dhe e përfaqësonte futbollin e Kosovës me dinjitet.

Kemi dhënë gjithçka për ta ngritur emrin e futbollit kosovar. Kemi investuar, kemi sakrifikuar dhe kemi luftuar në çdo ndeshje që flamuri dhe emri i Kosovës të përfaqësoheshin denjësisht në arenën ndërkombëtare.

Mjafton të shikohet se sa futbollistë të dalë nga FC Ballkani sot kanë arritur të veshin fanellën e Kombëtares së Kosovës dhe të Kombëtares së Shqipërisë. Kjo është puna jonë. Ky është investimi ynë. Kjo është ajo që FC Ballkani i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë futbollit shqiptar.

Prandaj, pas gjithë asaj që kemi investuar, sakrifikuar dhe dhënë për ngritjen e imazhit të futbollit të Kosovës, nuk do të lejojmë që djersa jonë të nëpërkëmbet nga askush.

Nuk po kërkojmë favore. Nuk po kërkojmë që dikush të na falë pikë. Nuk po kërkojmë të na bëjë askush kampionë, por vetëm drejtësi në referim.

Kërkojmë vetëm drejtësi. Kërkojmë trajtim të barabartë. Kërkojmë që atë që e fitojmë në fushën e lojës, të mos na e marrin jashtë saj.

MJAFT KEMI HESHTUR!

Edhe

Futboll • 25 tet 2025

Ballkani i shpëton humbjes me gol të minutave shtesë

Media

FC BALLKANI See less

#BALLKANI

Artikuj të ngjashëm

Futboll • 21 sht 2025

Llapi vazhdon pa fitore, mbetet i fundit

Futboll • 7 o. më parë

Malisheva fiton ndaj Ballkanit me përmbysje të rezultatit

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Perkdhimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Marketing

Politika e privatisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatisë dhe cookies

+383 (0) 38 249 105 /

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.